# CIDELY TOP

PRODUKT PER MBROJTEN E BIMEVE



**KUJDES**

**CIDELY TOP** është fungicid sistemik, me veprim parambrojtës dhe shërues. Përmban lëndët vepruese difenoconazole (triazol) që lëviz në mënyrë translaminare dhe ka veprim parambrojtës e shëruesdhe Cyflufenamid (amidoxime) që lëviz në mënyrë translaminare, ka veprim të avujve dhe efekt mbetës të zgjatur dhe paraqet veprim parambrojtës e shërues. Cidely Top është i përshtatshëm për t'u përdorur në Programet e Menaxhimit të Integruar.

**Përmbajtja:** *Difenoconazole 12,5 %+Cyflufenamid 1,5 %*

**Formulimi:** *Koncentrat i dispergueshem (DC)*

**Masat parambrojtëse:**

- Mbajeni ne vende te pa arriteshme nga femijet.
- Evitoni kontaktin me sytë dhe lëkurën.
- Mbroni rrugët e frymëmarrjes duke përdorur mjetet mbrojtëse.
- Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë përdorimit.
- Gjatë punës përdorni mjetet mbrojtëse.
- Pas pune duart dhe fytyra duhet të lahen dhe rrobat të ndërrohen.
- Lani pajisjet mbrojtëse para se t'i ripërdorni.
- Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, ndiqni me kujdes udhëzimet e përdorimit.
- Për mbrojtjen e përdoruesit duhet që ai të veshi doreza të përshtatshme si dhe syze e maskë për të mbrojtur sytë dhe fytyrën.
- Në rast se punëtorët duhet të hyjnë në parcelë menjëherë pas spërkatjes, duhet të veshin doreza.
- Mblidhni ambalazhet ne kontenjere dhe beni shkaterrimin e tyre sipas rregullave ne fuqi.

**Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:**

- Në përgjithësi: Në rast aksidenti ose nëse nuk ndiheni mirë, kërkoni menjëherë këshillë mjekësore (tregoni etiketën ku është e mundur).
- Në rast se merret me organet e frymëmarrjes: Nxirreni të aksidentuarin në vende të ajrosura. Mbajeni ngrohte. Nëse duhet, i bëni frymëmarrje artificial dhe thërisni mjekun menjëherë.
- Në rast kontakti me lëkurën: Hiqni menjëherë rrobat e ndotura, lani lëkurën me ujë të bollshëm e sapun. Nëse acarimi i lëkurës vazhdon, thërrisni mjekun. Lani mire rrobat e ndotura para se t'i rivishni.
- Shkakton dëme serioze në sy. Në rast kontakti me sytë: I lani ato me ujë të pastër e të bollshëm për 10-15 minuta dhe kërkoni këshillë mjekësore nqs duhet.
- Në rast gëlltitje: Thërrisni mjekun dhe i tregoni atije tiketën. Mos shkaktoni të vjella.
- Antidot specific nuk njihet. Mjekimi simptomatik.

**Përdorimi:**

Perdoret me spërkatje gjethore ne:

***Në perimet*** e familjes solanore (domate, spec dhe patlixhan): për të kontrolluar hiret *(Leveillula taurica, Erysiphe lycopersici),* alternariozën *(Alternaria solani),* njollosjen kafe të gjetheve *(Fulvia fulva),* me 1 lit/ha (100 ml/100 lit ujë). Spërkatje gjethore, që fillojnë 1 javë pas mbjelljes në vendin e përhershëm deri në fazën e pjekjes së frutave. Bëhen 2 trajtime në interval 10 ditë.

***Në perimet*** e familjes kungullore (shalqi, pjepër, trangull dhe kungull): për të kontrolluar hiret *(Podosphaera xanthii, Erysiphe cychoracearum, Sphaerotheca fuliginea Golovomyces cichoracearum),* alternariozën *(Alternaria cucumerina),* didymellën *(Didymella bryoniae),* kladosporiozën *(Cladiosporium cucumerinum),* me 1 lit/ha (100 ml/100 lit ujë). Spërkatje gjethore, që fillojnë 1 javë pas mbjelljes në vendin e përhershëm deri në fazën e pjekjes së frutave. Bëhen 2 trajtime në interval 10 ditë.

***Në lule shtrydhe:*** për të kontrolluar hiret *(Sphaerotheca macularis, Podosphaera macularis, Leveillula taurica),* antraknozën *(Colletotrichum acutatum, Mycosphaerella fragariae),* alternariozën *(Alternaria spp.),* me 1 lit/ha (100 ml/100 lit ujë). Spërkatje gjethore nga faza e daljes së gjethit të 9$^{të}$ deri në fazën e pjekjes së frutave. Bëhen 2 trajtimenë interval 10 ditë.

Mënyra e përgatitjes së tretësirës spërkatëse: Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse. Shtoni dozën e rekomanduar të Cidely Top dhe, duke vazhduar përzierjen, plotësoni pompën me sasinë tjetër të ujit.
Periudha e rifutjes në parcelat e trajtuara: Deri sa të thahet tretësira spërkatëse në sipërfaqen e gjetheve.

**Fitotoksiciteti**:
Nuk është fitotoksik kur përdoret sipas udhëzimeve të përdorimit.

**Vërejtje per perdorimin**:
Përzihet me shumicën e insekticideve, fungicideve dhe rregullatorëve të rritjes.
Për të evituar zhvillimin e rezistencës ndaj hirit, rekomandojmë që numri i trajtimeve me preparate që përmbajnë lëndën vepruese cyflufenamid nuk mos tejkalojnë 1/3 e numrit të trajtimeve për mbrojtjen e bimëve gjatë një sezoni. Mos hyni në parcelat e trajtuara para se gjethet të jenë tharë plotësisht.

**Karenca**:
Perime të fam solanore, kungullore dhe lule shtrydhe 3 ditë.

**Ndikimi ne mjedis:**
I dëmshëm për organizmat ujorë, me efekte afatgjata.
Mos ndotni ujin me preparation ose me ambalazhin e tij.
Mos lani pajisjet spërkatëse pranë ujërave sipërfaqësore.
Për të mbrojtur organizmat ujorë përdorni sprucatorë special që pakësojnë deri në 50 % transportin e mjegullës spërkatëse, ose lini një sipërfaqe të pa trajtuar prej 5 m.

**Magazinimi:**
Preparati ruhet në ambalazhin original, në vende të ajrosura, pa lagështi dhe jo në kontakt me rrezet e diellit, në temperature -5 deri $35^0$ C.

Nr dhe data e regjistrimit: 653, datë 15.12.2016.
Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: 50 ml, 100 ml, 250 ml, 500 ml dhe 1 litër.
Data e prodhimit: ;
Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 3 vjet;
Numri i partise se mallit (serise) ose shenja te tjera identifikuese: ;
Lloji i ambalazhit baze: Shishe HDPE, PET, fHDPE, HDPE/PA.
Emri dhe adresa e Aplikantit: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Basel, Switzerland.
Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Basel, Switzerland.